



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I QARKUT DIBËR

Nr. 144/4 prot.

Peshkopi, më 19.07.2023

VENDIM

Nr. 13 Datë 19.07.2023

PËR

“MIRATIMIN E NDRYSHIMIT NË NIVELIN E PAGAVE TË PERSONELIT TË  
KËSHILLIT TË QARKUT DIBËR”

Në mbështetje të ligjit 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 72 pika 5, neni 77 pika “ç”, neni 83; ligjit nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 40; ligjit Nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligjit nr. 2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Ligjin nr. 45/2015 “Kodi I Procedurave Administrative i RSH”, nenet 104-105, VKM Nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore” dhe VKM Nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagën të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve,, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike, Këshilli i Qarkut në mbledhjen e dt. 19.07.2023, pasi mori në shqyrtim vendimin e Kryesisë nr. 13, dt 19.07.2023 “Për miratimin e ndryshimit të nivelit e pagave të personelit të Këshillit të Qarkut Dibër, me 13 (trembëdhjetë) pro,

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimin në nivelin e pagave për pozicionet e punës së administratës së Këshillit të Qarkut Dibër sipas tabelës I që i bashkëngjitet këtij Vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij Vendimi të fillojnë në datën 01 Prill 2023.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimin ngarkohet Sektori i Financës, Sektori Juridik dhe Projekteve.
4. Vendimi të dërgohet pranë institucionit të Prefektit për verifikimin e Ligjshmërisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
6. U shpall sot më dt 19.07.2023.

KRYETAR

Alma Selami

